



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:101175

Datë: 01.09.2022

Numri i dokumentit: 03382024

P.nr. 207/22

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti, me sekretaren juridike Flutur Nagavci në çështjen penale kundër të akuzuarit G. A. nga Gjakova, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së PTH- DP në Gjakovë PP/II.nr.606/22 të datës 19.05.2022, në bazë të nenit 358 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK-së si dhe nenit 11 të Ligjit Mbi Ndërmjetësimin 06/nr.L-009, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor me datës 28.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim e lidhur në mes të akuzuarit G. A. nga Gjakova dhe të dëmtuarit B. Sh. nga fshati . . . Komuna Gjakovë , në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gjakovë, Nd. nr.71/72 të datës 22.08.2022.

II. HUDHET aktakuza e PTH-DP në Gjakovë, PP/II.nr.606/22 të datës 19.05.2022, dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të akuzuarit G. A. nga Gjakova ,për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.606/22 të datës 19.05.2022, kundër të akuzuarit G. A. nga Gjakova , për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar në këtë çështje penale dhe se pas njoftimit të dëmtuarit se me të akuzuarin kanë arritur marrëveshje dhe janë pajtuar për këtë çështje penale, Prokurori i shtetit nuk e ka kundërshtuar vetë iniciimin e palëve që të shkojnë në procedurën e ndërmjetësimit, ku të dy palët si i akuzuari dhe të dëmtuara janë pajtuar, gjyqtari e ka ndërprerë seancën dhe i ka udhëzuar palët se këtë çështje mund ta zgjedhin edhe me ndërmjetësim.

Me datën 22.08.2022 , në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gjakovë, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar ndërmjet të akuzuarit G. A. nga Gjakova dhe të dëmtuarit B. Sh. nga fshati . . . Komuna Gjakovë .

Palët pa ndonjë kërcënim dhe me vet dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes për ndërmjetësim.

Qendra për Ndërmjetësim me vendim Nd.nr. 71/22 e datës 22.08.2022 ,ka pranuar marrëveshjen e palëve për zgjidhje të ndërmjetësuar.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenin 358 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së dhe nenit 11 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin 06/nr.L-009 të dt. 23 korrik 2018,vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P.nr.207/22 të dt. 28.08.2022

Sekretarja juridike
Flutur Nagavci

Gjyqtarja
Ilirjana Hoti

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.